



Organization for Security and
Co-operation in Europe
Presence in Albania

FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS SË OSBE-SË NË CEREMONINË E DIPLOMIT NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS

22 dhjetor 2011

Kryetarja Beçaj,
Drejtoreshë Semini,
Prokurorja e Përgjithshme Ina Rama,
Shkëlqesi,
Kolegë të nderuar,
Zonja dhe zotërinj,
Mirëmëngjesi!

Shteti i së Drejtës përbën themelin e mandatit të OSBE-së, të misionit tonë. Për këtë arsye, është me rëndësi të veçantë të jem këtu me ju sot, në Shkollën e Magjistraturës, të cilën unë, të cilën Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, e konsideron vendin thelbësor, ku "bëhet drejtësia", ku përcaktohet dhe është përcaktuar për vite me radhë rruga drejt një sistemi drejtësie në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare.

Një edukim i shëndoshë ligjor është një domosdoshmëri e padiskutueshme: si për profesionalizmin dhe për çfarëdolloj përmirësimi real në sektorin e drejtësisë, po aq edhe për karrierën personale. Etika është një nga mjetet e rëndësishme të punës suaj. Nuk ju lejon që të zgjidhni pandëshkrueshmërinë, edhe atëherë kur mund të mendonit se s' do të kishit pasoja.

Nuk është sekret që një sistem drejtësie transparent dhe i besuar përbën shtyllën kryesore të çdo shoqërie paqësore dhe demokratike në ofrimin e një kundërpeshe të pavarur në sistemin e garancive dhe ekuilibrit të të tre pushteteve të qeverisjes përshkruar nga *Montesquieu*.

Ndërkohë që miratimi i ligjeve të shëndosha dhe të mirëhartuara, nëpërmjet një procesi parlamentar transparent, formon bazën e shtetit të së drejtës në vend, ato mbeten vetëm letra pa jetë, nëse askush nuk është i ndërgjegjshëm për to, nuk i njeh dhe nuk i zbaton këto ligje.

Zbatimi i ligjit në mënyrë të drejtë, të barabartë dhe të pavarur përbën të drejtën kryesore të gjyqësorit.

Në këndvështrimin tim, Shkolla e Magjistraturës ofron themelet më të forta për një sistem drejtësie eficient dhe transparent në Shqipëri, duke bërë të mundur kombinimin e njohurive teorike me zbatimin e tyre në praktikë, duke u dhënë kështu njohuri dhe aftësi të konsoliduara magjistratëve të ardhshëm.

Megjithatë, ekspertiza e lartë në të gjitha nivelet dhe në punën profesionale nuk arrihet vetëm nëpërmjet trajnimit profesional. Për të përmbushur përgjegjësinë e madhe sociale që u jepet gjyqtarëve dhe prokurorëve, kërkohen standardet më të larta etike.

Sapo emërohesh në një detyrë në sistemin gjyqësor, zotëron një pushtet dhe liri veprimi të pamasë, që ia kalon shumë herë kapacitetit të pjesës më të madhe të burrave dhe grave. Juve ju

jepet fuqia për të vendosur lirinë ose robërinë; fuqia për të vendosur kush fiton e kush mbetet duarbosh.

Ky pushtet kaq i madh duhet përdorur me shumë kujdes, duhet zbatuar me maturi dhe duhet shijuar rrallë - gjithmonë dhe vetëm në interesin e publikut.

Gjykatësi amerikan Ringera tha në vitin 2007: “Kur gjyqtarët rriten në postin e tyre dhe nuk arrijnë të bëjnë dallimin midis personit të tyre si individë dhe detyrës së tyre si institucion, aty fillon të lindë shpërdorimi i pushteti dhe nxitja e anarkisë.”¹

Do të doja të shtoja edhe prokurorët në citimin që sapo përmenda për gjyqtarët.

Bashkë me përgjegjësinë e madhe sociale të detyrës së gjyqtarit dhe prokurorit nuk vjen vetëm liria për të qenë i pavarur, por edhe përgjegjësia për të vepruar në mënyrë të pavarur, përgjegjësia për ta përdorur këtë detyrë për të vënë drejtësi, dhe jo për përfitime vetjake.

Siç kam thënë edhe me herët, trajtimi i prerë dhe transparent i çështjeve që përfshijnë korrupsionin, pavarësisht statusit të të akuzuarve, mbetet një tregues kyç i pavarësisë së gjyqësorit.

Më lejoni të theksoj: korrupsioni në sistemin gjyqësor mund të pastrohet vetëm nëpërmjet gjyqësorit. Dhe DUHET të pastrohet nëpërmjet gjyqësorit.

Për këtë qëllim, sistemet e përgjegjshme dhe efçente të inspektimit dhe ndjekjet disiplinore për gjyqtarët janë vendimtare; dhe bashkëpunimi i fortë brenda sektorit të gjyqësorit, veçanërisht me prokurorinë, është i domosdoshëm për ta pastruar me efikasitet kopshtin e kushtueshëm të drejtësisë nga fara e keqe e korrupsionit.

Të nderuar pjesëmarrës,

Në mbyllje të komenteve të mia, do të doja t'u drejtoheshia drejtpërdrejt të diplomuarve.

Të dashur të diplomuar,

Me largimin nga ky institucion i nderuar akademik, ju do të jeni pjesë e sistemit gjyqësor.

Si të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës, ju keni një përgjegjësi të veçantë për shtetin e së drejtës dhe, në këtë mënyrë, edhe për mirëqenien e përgjithshme të vendit tuaj. Mbrojtja e një shteti ku sundon ligji është në duart tuaja. Bëjeni etikën pjesë të tij në çdo rast e rrethanë. Ai varet nga ju. Mund të venitet për shkakun tuaj. Por me ju, ai mund, dhe unë uroj, që të rritet.

Kjo është një përgjegjësi e madhe, por edhe një nder i madh.

Dëshiroj t'ju përgëzoj për rrugën që keni zgjedhur.

Ju uroj gjithë të mirat për karrierat tuaja profesionale në të ardhmen.

Faleminderit shumë!

¹ "Korrupsioni në Gjyqësor", Prezantim nga Gjykatësi Aaron G. Ringera, Drejtor dhe Shef Ekzekutiv i Komisionit të Anti-Korrupsionit për Kenian, 25 prill 2007, Banka Botërore, Washington D.C.